



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:263345

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05619669

K.Dh.Shk.II.nr.242/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Komuna e Mitrovicës ndaj debitorit Trepça Sh.A me seli në Mitrovicë së Jugut, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2500/22 të datës 30.11.2023, me datë 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.2500/22 i datës 30.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës–Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2500/2022 të datës 30.11.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Trepça” Sh.A, dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.1123/22, të datës 27.10.2022, i Përmbaruesit Privat Atip Mustafa me seli në Vushtri.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Komuna e Mitrovicës së Jugut, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovohet ankesa e kreditorit, të anulohet aktvendimi KPPP.nr.2500/22 i datës 30.1.2023, leshura nga Gjykata Komerciale e Kosovës dhe të mbetet në fuqi Urdhri për Përmbarim P.nr.1123/22 i datës 27.10.2022, lëshuar nga përmbaruesi privat Atip Mustafa dhe të detyrohet debitori Trepça Sh.a me seli në Mitrovicë, që t’i paguaj të gjitha shpenzimet nga procedura përmbarimore dhe shpenzimet e angazhimit të avokatit sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Komuna e Mitrovicës së Jugut, me datën 02.10.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit “Trepça” Sh.A me seli në Mitrovicë, në bazë të dokumentit të besueshëm – Vendim për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara të datës 10.10.2022 pa numër, në shumën prej 998,902.93€.

Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit 1 ka caktuar urdhrin P.nr.1123/22 të datës 27.10.2022 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Vendim për ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara të datës 10.10.2022 pa numër, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ja paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas vendimit shumën prej 998,902.93€, me kamatë prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.2500/2022 të datës 30.11.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Trepça” me seli në Mitrovicë dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.1123/22, të datës 27.10.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa me seli në Prishtinë.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar Gjykata vlerëson se Kjo situatë rregullohet me nenin 38 të LPP-së, i cili në para. 1 shprehimisht ka rregulluar se “Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”, ndërsa në para. 2 ka urdhëruar që “Në rast se propozimi për përmbartim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbartues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”. Nga këto dispozita rrjedhë se, propozimi për përmbartim, mes tjerash, duhet ta përmbajë numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, kur ky është shoqëri tregtare, ndërsa numrin personal të debitorit kur ky është person fizik, kurse në rast se në propozimi për përmbartim nuk e përmban këtë të dhënë, atëherë organi përmbartues është i obliguar që të veproj sipas nenit 102 të LPK-së, sipas të cilit propozimi për përmbartim, si parashtesë, duhet të kthehet për korrigjim. Në rastin konkret, te të dhënat e Debitori mungon numri i regjistrimit të biznesit

për Debitorin, ndërsa siç u sqarua edhe më lartë, Përmbartuesi ka dështuar që ta ftoj Kreditorin që ta rregulloj Propozimin në kuptim të të dhënave të Debitorit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbartimi, Vendimi datës 10.10.2022 pa numër, i kreditorit, nuk përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit pasi që nuk paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 i cili përcakton “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër” si dhe nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument përmbartues në përputhje me nenin 22 par. 1 nën par. 1.2 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: “1.Dokumente përmbartuese janë: ...1.2. vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”. Në rastin konkret dokumenti përmbartimor Vendimi datës 10.10.2022 pa numër, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbartim të përcaktuara me nenin 24 par. 3 dhe nenin 36 par. 1 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: “Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”, pasi që i njëjti nuk përmban klauzolën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka pranuar si të bazuar prapësimin, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lëndës rezulton se vendimi mbi të cilin përmbartuesi privat e ka lejuar urdhrin përmbartimor të debitorit nuk paraqet dokument përmbartimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbartimor nuk i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimor. Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës

Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka pranuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin për caktimin e përbarimit të lejuar nga Përbaruesi Privat dhe kur e ka përfunduar procedurën në këtë çështje përbarimore.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se caktimi i numrit të biznesit është i rëndësishëm së veçantë, përkatësisht numri i biznesit e përcakton se cili subjekt saktësisht është debitor në këtë procedurë përbarimore.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përbarimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përbarimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përbarimi janë tiparet e përbarueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 38 dhe 43 par.4 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit, prandaj dhe dokumentet e besueshme në raport me dokumentet tjera përbarimore duhet ta kenë fuqinë e pa kontestuar ekzekutive në mënyrë që procedura përbarimore të iniciohet përmes këtyre dokumenteve.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.242/24 dt. 24.04.2024

**Gjyqtari,
Ramush Bardiqi**